



GJYKATA KOMERCIALE – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Krenar Berisha dhe Saranda Bogaj-Shermeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses “I...” sh.p.k me seli ne Istog, te cilën e përfaqëson drejtori L.Sh, e te cilën sipas autorizimit D.K, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, ne Prishtinë, duke vendosur përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 27.09.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

Për gjykim në këtë çështje juridike është kompetente në pikëpamje lëndore Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, të cilës i dërgohen shkresat e lëndës në veprim të mëtejme.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, me aktvendimin e saj është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur në çështjen juridike kontestimore, sipas padisë me numër A.nr.2801/2018 dhe pasi që ka marre forme te prete aktvendimi, lenden e ka dërguar ne te njëjtën gjykate, ne Departamenti për Çështje Ekonomike.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike (pas pranimit te lendes nga Departamenti për çështje administrative) ka ushtruar propozim për vendosjen e konfliktit të kompetencës pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, me të cilën e ka iniciuar konfliktin e kompetencës duke konsideruar se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, është kompetent në pikëpamje lëndore për vendosje në këtë çështje juridike.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë pas shqyrtimit të shkresave të lëndës vlerëson se kompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike është Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, për arsye se objekt kontesti është kompensimi i demit ndërmjet subjekteve. Pra nga shikimi ne shkresat e lendes rezulton se te dyja palët ndërgjyqëse janë persona juridik, ku paditësja rezulton te jete person juridiko-privat e cila ka formën e organizimit të shoqërisë me përgjegjësi te kufizuar, ndërsa e paditura person juridiko-publike, andaj sipas nenit 13 te Ligjit për Gjykatën Komerciale ne mënyrë decitive përcaktohet se gjykatë kompetente për te gjykuar ne këto konteste është Gjykata Komerciale, e ku nën par.1.1, i kësaj dispozite ka përcaktuar se “Gjykata Komerciale është kompetente për te gjykuar dhe ka

juridiksion ekskluzivisht ne kontestet ndërmjet shoqërive tregtar vendore dhe te huaja si dhe kontestet ndërmjet personave juridik publik dhe privat, ne lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre.”

Mbi këtë bazë Gjykatës Komerçiale-Dhoma e shkallës së dytë konstaton se gjykate kompetente për te vendosur ne këto çështje ne shkalle te pare është Gjykatës Komerçiale-Dhoma e shkallës së parë.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 25.1 të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË
Kom.Dh.Shk.II.nr.825/2022 dt.27.09.2022

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Faton Bajrami, d.v